

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin prill

2023

maj 2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin prill

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, maj 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkruës, i pari i këtij lloji në Kosovë deri më tash, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit prill 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i dhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në kuadër të raportit jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të jep një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Edhe gjatë muajit prill 2023, në kategorinë vlerësuese “Clickbait” ka pasur më së shumti artikuj me përmbajtje keqinformuese, të krijuara dhe shpërndara nga mediat e ndryshme prej 42%. Në krahasim me muajin paraprak monitorues (mars 2023), kjo kategori ka shënuar rritjen më të madhe deri më tash prej kur platforma për kontroll të fakteve “hibrid.info” mat gjendjen e keqinformimit në Kosovë – pra ka rritje prej 15% të keqinformimeve në këtë kategori për këtë muaj (nga 27% gjatë muajit mars në 42% në muajin prill). Risi tjetër e këtij muaji monitorues është se në vendin e dytë është kategoria “Lajm i rremë” me 15%, pasuar nga “Përmbajtje e paverifikuar” me 13%, ndërsa vërehet se kishte shumë më pak keqinformime të vlerësuara në kategorinë “Dezinformatë” me 12% gjithsej, duke u renditur në vendin e katërt për këtë muaj.



42% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin “Clickbait”.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. Clickbait

Të gjitha publikimet keqinformuese që kanë marrë vlerësime në këtë kategori janë publikuar nga mediat në gjuhën shqipe, në fushat e kronikës së zezë dhe çështjeve sociale. Publikimet keqinformuese në këtë kategori trajtojnë tema të ndryshme, si aksidente, arrestime, plagosje, rrëmbime, vjedhje, vrasje, programi televiziv “Big Brother VIP Albania” (BBVA), emigrantët etj. Në këtë kategori kanë marrë shumë më pak vlerësime artikujt keqinformues në fushën politike, ndërsa në atë të sigurisë nuk kishte asnjë publikim. Shumica dërmuese e publikimeve të kësaj kategorie janë publikuar nga media reale, si dhe shumë më pak në mediat sociale dhe ato të dyshimta.

03. Përmbajtje e pa verifikuar

Artikujt me përmbajtje të paverifikuar në fushën e sigurisë kanë marrë më së shumti vlerësime në këtë kategori, të cilat trajtojnë veriun e Kosovës dhe komunitetin serb në Kosovë. Të gjitha publikimet keqinformuese në fushën e sigurisë janë krijuar dhe shpërndarë nga mediat reale në gjuhën serbe. Publikime të tjera në këtë kategori vlerësuese, por në numër shumë më të vogël, i përkasin fushës sociale për minatorët e Trepçës dhe muajin e Ramazanit, të cilat për dallim prej fushës së sigurisë, janë publikuar në mediat sociale, në gjuhën shqipe.

05. Mashtrim

Në kategorinë e mashtrimit janë vlerësuar si publikime keqinformuese disa shpallje, kronika e zezë dhe çështjet sociale, që të gjitha në përqindje më të vogël në krahasim me kategoritë tjera vlerësuese më lartë. Shumica e këtyre artikujve janë shpërndarë në mediat sociale dhe më pak në mediat e dyshimta, si dhe të gjitha prej tyre janë në gjuhën shqipe.

Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë “Manipulim i fakteve” dhe nga kombinimi i kategorive “Dezinformatë / Clickbait”, në të cilat trajtohen keqinformime në fushën politike dhe të sportit.

02. Lajm i rremë

Artikujt keqinformues për çështjet politike dhe të sigurisë kanë marrë më së shumti vlerësime të lajmeve të rreme, në të cilat trajtohen publikimeve të pabazuara në fakte për ish-presidentin Thaçi, kryeministrin shqiptar, Edi Rama, si dhe për veriun e Kosovës. Publikime tjera të kategorizuara si lajme të rreme janë për çështje sociale, kronikën e zezë dhe sundimin e ligjit. Artikujt keqinformues të kësaj kategorie janë publikuar dhe shpërndarë në mediat sociale, në gjuhën shqipe.


04. Dezinformatë

Të dhënat monitoruese tregojnë se gjatë muajit prill 2023 kishte pasur dukshëm më pak publikime që kanë marrë vlerësime në kategorinë e dezinformatës. Mbase ky është muaji i parë, prej kur platforma “hibrid.info” ka nisur monitorimin mujor në korrik të vitit 2022, kur në kategorinë dezinformatës ka më së paku publikime keqinformuese. Megjithatë, edhe këtë muaj (prill 2023), artikujt keqinformues në fushën politike kanë mbizotëruar, siç janë ato për veriun e vendit, diasporën shqiptare në Gjermani etj. Gjithashtu, edhe disa keqinformime për çështjet sociale dhe kronikën e zezë janë vlerësuar si dezinformatë. Publikimet në këtë kategori janë krijuar dhe shpërndarë në gjuhën shqipe, kryesisht në mediat sociale dhe portalet e dyshimta.

06. Teori konspirative

Publikimet keqinformuese në këtë kategori janë në fushën politike dhe të sigurisë për veriun e Kosovës dhe komunitetin serb në vend. Ato janë publikuar nga mediat reale në gjuhën serbe, në raportimet keqinformuese të këtyre të fundit në raport me Kosovën.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese



Në krahasim me muajt paraprak monitorues të vitit 2023, karakteristikë e këtij muaji (prill 2023) është se tema kryesore që ka mbizotëruar janë zhvillimet lidhur me veriun e Kosovës. Në të vërtetë, ka qenë e pritshme që gjatë muajit prill 2023 të ketë më shumë keqinformime për veriun e vendit nisur edhe nga fakti se, më 23 prill 2023, janë mbajtur zgjedhjet lokale në katër komunat veriore të Kosovës, të cilat u bojkotuan nga subjektet politike serbe dhe qytetarët e komunitetit serb në këto komuna si pasojë e presioneve nga Lista serbe dhe Serbia.

Artikujt keqinformues për veriun më së shumti janë shpërndarë nga mediat reale në gjuhën serbe dhe më pak nga ato në gjuhën shqipe. Raportimet keqinformuese të mediave në gjuhën serbe për veriun e Kosovës pretendojnë pa fakte se Policia e Kosovës ka keqtrajtuar e plagosur qytetarë serbë në veri, si dhe pretendimin tjetër të pavërtetë se ekziston një plan për spastrimin e serbëve nga veri. Ndërsa, publikimet keqinformuese për veriun në gjuhën shqipe janë publikuar në mediat sociale dhe ngritin pretendime të rreme se grupi rus “Wagner” ka plagosur disa pjesëtarë të Policisë Kosovës, transmetojnë një deklaratë të vjetër të kryeministrit Kurti duke e paraqitur atë si aktuale dhe pretendimin e rremë se Policia në veri ka vrarë tre qytetarë serbë.

Temat tjera të trajtuara ndërlidhen me kronikën e zezë, çështjet sociale dhe shpallje, si arrestime, plagosje, vrasje, keqinformime për programin televiziv BBVA etj.



39% e temave kryesore janë për veriun e Kosovës, vrasje, programin televiziv BBVA, arrestime, komunitetin serb në Kosovë, plagosje etj.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Matjet në muajin prill 2023 tregojnë se, pavarësisht që veriu i Kosovës është tema kryesore e trajtuar nga mediat në publikimet e tyre keqinformuese, megjithatë edhe tema tjera të kronikës së zezë dhe çështjeve sociale kanë dominuar po ashtu, ngjashëm si në muajt paraprak monitorues të vitit 2023. Krahas veriut, mediat i kanë kushtuar vëmendje të madhe edhe disa artikujve keqinformues lidhur me vrasje, arrestime dhe programin televiziv BBVA.

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga mediat e ndryshme, sipas matjeve të “hibrid.info” përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Veriu

Publikimet keqinformuese për veriun janë vlerësuar në kategoritë e dezinformatës, lajmeve të rreme, përmbajtjes së paverifikuar dhe teorisë konspirative. Shumica prej tyre janë publikuar nga mediat reale në gjuhën serbe dhe pjesa tjetër në gjuhën shqipe, në mediat sociale. Për veriun janë shpërndarë kryesisht pretendime të rreme dhe të pabazuara në fakte nga ana e mediave serbe, se qytetarët serbë në veri të Kosovës janë të kërcënuar nga institucionet e shtetit të Kosovës.

03. BBVA

Artikujt me përmbajtje keqinformuese për programin televiziv BBVA janë vlerësuar në kategoritë e mashtrimit dhe clickabait. Të gjitha ato janë shpërndarë nga portale të dyshimta në gjuhën shqipe dhe në këto publikime keqinformuese bëhet fjalë për votimet online në kuadër të BBVA-së.

02. Vrasje

Të gjitha publikimet për temën e vrasjeve janë krijuar dhe shpërndarë nga media reale në gjuhën shqipe. Këta artikuj kanë marrë vlerësime clickbait dhe trajtojnë disa ngjarje për të cilat nuk ka qartësi për vendndodhjen e tyre.

04. Arrestime

Edhe keqinformimet për disa arrestime kanë marrë vlerësime clickbait dhe janë krijuar e shpërndarë nga mediat reale në gjuhën shqipe. Artikujt e shpërndarë për këtë temë nuk qartësojnë në tituj se ku kanë ndodhur rastet e arrestimeve.


3

Llojet e fushave

Të dhënat nga monitorimi mujor tregojnë për një risi tjetër sa i përket temave dhe fushave më të trajtuara lidhur me gjendjen e keqinformimit për dhe rreth Kosovës nga raportimet e mediave të ndryshme. Përderisa veriu i Kosovës ka dominuar mbi temat tjera në kuadër të fushës politike dhe të sigurisë gjatë muajit prill 2023, megjithatë numri më i madh i artikujve keqinformues janë publikuar në fushën e kronikën së zezë me 29% dhe çështjeve sociale me 24%. Këto dy fusha i kanë lënë në hije artikujt me tematikë politike prej 20% dhe ato të sigurisë me 14%.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore




Artikujt keqinformues në kronikën e zezë janë publikuar në gjuhën shqipe nga mediat reale dhe në mediat sociale, si dhe kanë trajtuar tema të ndryshme, përfshirë vrasje, plagosje, aksidente, arrestime, vjedhje, rrëmbime etj.

Edhe temat sociale janë krijuar dhe shpërndarë nga mediat në gjuhën shqipe, në masën më të madhe në mediat sociale dhe dukshëm më pak në portalet e dyshimta dhe mediat reale. Tematika e këtyre publikimeve ndërlidhet me programin televiziv BBVA, çmimet, emigrantët, minatorët e Trepçës dhe tema të tjera sociale. Shumica dërrmuese e artikujve në kronikën e zezë dhe të çështjeve sociale kanë marrë vlerësime clickbait, si dhe dukshëm më pak janë kategorizuar si dezinformatë, përmbajtje e paverifikuar, lajm i rremë dhe mashtrim.

Sa i përket keqinformimeve në fushën politike, shumica prej tyre janë shpërndarë në mediat sociale dhe në numër dukshëm më të vogël në portalet e dyshimta dhe mediat reale. Pothuajse të gjitha temat në fushën politike janë në gjuhën shqipe dhe trajtojnë çështje të ndryshme, si arrestime, diasporën shqiptare në Gjermani, keqinformime për ish-presidentin Thaçi dhe kryeministrin shqiptar, Rama, krimet e luftës etj. Këto publikime kanë marrë vlerësime të lajmit të rremë, dezinformatës, clickbait, manipulim i fakteve dhe teori konspirative.

Ndërkaq, publikimet keqinformuese në fushën e sigurisë janë krijuar dhe shpërndarë kryesisht nga mediat reale në gjuhën serbe për veriun e Kosovës dhe komunitetin serb në Kosovë. Publikimet keqinformuese në kuadër të fushës së sigurisë janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar, manipulim i fakteve dhe teori konspirative.





93% e përmbajtjeve keqinformuese janë për kronikën e zezë, çështjet sociale, politikën, sigurinë dhe sportin.

4

Llojet e publikuesve

Edhe në muajin prill 2023, mediat reale dhe faqe e llogari të ndryshme në mediat sociale kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese për Kosovën. Sipas matjeve të monitorimit mujor, 48% e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar dhe shpërndarë nga mediat reale dhe 40% në mediat sociale. Ndërsa, rreth 12% e artikujve keqinformues janë publikuar e shpërndarë nga portalet e dyshimta.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



88% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar në mediat reale (48%) dhe mediat sociale (40%).


5

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe. Gjatë muajit prill 2023, nuk kishte publikime keqinformuese të mediave në gjuhë të tjera në raport me Kosovën (pos mediave në gjuhën shqipe dhe serbe).

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË
MEDIAVE NË GJUHËN SHQIPE
DHE SERBE

Publikimet në gjuhën serbe
12%



Publikimet në gjuhën shqipe
88%

Edhe gjatë muajit prill 2023, mediat në gjuhën shqipe kanë publikuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 88%, ndërsa 12% prej tyre janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe. Në raport me muajin paraparak (mars 2023), në muajin prill 2023 vërehet rritje e artikujve keqinformuese nga mediat në gjuhën shqipe (prej 7%) dhe një rënie e lehtë e atyre në gjuhën serbe (prej 4%).

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe dhe serbe. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet e mediave në gjuhën shqipe

Pjesa më e madhe e keqinformimeve në gjuhën shqipe janë publikuar në mediat sociale dhe mediat reale nga publikues të ndryshëm. Publikimet e mediave në gjuhën shqipe kanë marrë më së shumti vlerësime clickbait, lajm i rremë, përmbajtje e paverifikuar, dezinformatë dhe mashtrim. Mediat në gjuhën shqipe, gjatë këtij muaji, kanë publikuar më së shumti keqinformime për kronikën e zezë, çështjet sociale dhe politikën lidhur me tema të ndryshme të trajtuara në seksionet paraprake të raportit.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe


Artikujt keqinformues të mediave në gjuhën serbe kanë trajtuar vetëm çështje të politikës dhe sigurisë që ndërlidhen me zhvillimet në Kosovë për veriun e vendit dhe komunitetin serb në Kosovë. Këto publikime janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar dhe teori konspirative, duke shpërndarë pretendime të rreme dhe pa fakte, se komuniteti serb në veri të Kosovës është nën kërcënim të Policisë së Kosovës dhe institucioneve tjera kosovare. Të gjitha publikimet në gjuhën serbe janë publikuar dhe shpërndarë nga mediat reale.

Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Edhe këtë muaj (prill 2023), si në muajt paraprakë monitorues, në Facebook janë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 62% dhe në TikTok prej 38%. Krahasimi i matjeve me muajin paraprak (mars 2023) tregon se ka një rënie të publikimeve në Facebook prej 7% dhe rritje të keqinformimeve në TikTok prej 13%.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje analizon, përmes të dhënave monitoruese, ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, faqeve zyrtare dhe llogarive që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Gjatë muajit prill 2023, faqet me 57% dhe faqet zyrtare me 5% në Facebook kanë publikuar dhe shpërndarë më së shumti artikuj keqinformues (62% gjithsej) dhe llogari të ndryshme në TikTok prej 38%. Të gjitha publikimet keqinformuese në mediat sociale janë në gjuhën shqipe.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE



Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese.

01. Facebook

Faqet - Faqet në Facebook kanë publikuar dhe shpërndarë më së shumti artikuj keqinformues për çështjet sociale, politikën, kronikën e zezë dhe shpallje për tema të ndryshme, si çmimet, dhurim të pasurisë, platformën “Superpuna”, muajin e Ramazanit, veriun e Kosovës, krimet e luftës, veriun e Kosovës etj.

Faqet zyrtare - në këtë media sociale kanë publikuar vetëm një artikull keqinformues për minatorët e Trepçës. Shumica e publikimeve në Facebook kanë marrë kryesisht vlerësime clickbait, dezinformatë dhe mashtrim.


02. TikTok

Gjatë muajit prill 2023, llogaritë në TikTok kanë publikuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese për çështje politike, sigurinë dhe kronikën e zezë. Në kuadër të tyre përfshihen keqinformime për ish-presidentin Thaçi, kryeministrin e Shqipërisë, Rama, veriun e Kosovës etj. Shumica dërrmuese e publikimeve në llogaritë e TikTok janë vlerësuar si lajm i rremë dhe një publikim tjetër si mashtrim.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES




Për dallim prej dy muajve paraprakë monitorues (shkurt dhe mars 2023), kur kishte dukshëm më pak institucione më të përfolura si pasojë e raportimit dhe mbulimit të temave të tjera nga mediat, gjatë muajit prill 2023 vërehet një rritje e numrit të institucioneve të përfolura nga raportimet keqinformuese të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe. Kjo mund të jetë edhe për shkak të rritjes së publikimeve keqinformuese për temat politike dhe të sigurisë, marrë parasysh se edhe institucionet më të përfolura ndërlidhën me këto dy fusha tematike (politikë dhe siguri).

Institucioni më i përfolur këtë muaj është Policia e Kosovës, nga mediat në gjuhën shqipe e serbe, lidhur zhvillimet në veri të Kosovës. Mediat reale në gjuhën serbe, në pretendimet e tyre pa fakte, duke cituar mes tjerash edhe drejtorin e Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe, Petar Petkoviç, raportuan se Policia e Kosovës ka plagosur një qytetar serb në veri të vendit, por kjo ishte mohuar nga Policia e Kosovës. Po ashtu, disa llogari në TikTok, në gjuhën shqipe, pretendonin se grupi rus “Wagner” ka plagosur shtatë pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe se Policia e Kosovës ka vrarë tre qytetarë serbë, që u vlerësuan si lajme të rreme. Ndërkaq, Policia e Kosovës është vënë në kontekst dhe kombinim edhe me Listën Serbe dhe Zyrën për Kosovën në Qeverinë serbe, nga ana e mediave serbe, që publikuan pretendime të pavërteta se Policia ka keqtrajtuar një qytetar serb në Jarinjë dhe një grua serbe në veri.

Institucione tjera të përfolura janë Qeveria e Kosovës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe institucione e mekanizma të tjerë.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Edhe gjatë muajit prill 2023, kryeministri Albin Kurti është personaliteti më i përfolur nga mediat në gjuhën shqipe dhe serbe lidhur me disa keqinformime në fushën politike dhe të sigurisë. Sa i përket mediave në gjuhën serbe, ato kanë publikuar artikuj të vlerësuar si teori konspirative, me pretendime të pabazuara në burime të besueshme dhe fakte, se institucionet e Kosovës të udhëhequra nga Kurti po planifikojnë spastrimin e serbëve nga veriu i Kosovës. Ndërkaq, disa faqe në gjuhën shqipe, në Facebook, kanë publikuar disa artikuj keqinformues duke nxjerrë jashtë kontekstit deklarata të Kurtit dhe duke i paraqitur si aktuale disa prej deklarimeve të tij për veriu e Kosovës.

Personalitete të tjera të përfolura janë ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, futbollisti Vedat Muriqi etj.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjitha artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore dhe atë në formë kryesisht kuantitative për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmuajore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër dezinformatës dhe lajmeve të rreme. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 30 prill 2023.

Përfundime

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit prill 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Monitorimi gjatë muajit prill 2023 dëshmon se mediat kanë publikuar dhe shpërndarë më së shumti artikuj keqinformues në kategorinë clickbait me 42%, e cila pasohet nga lajm i rremë me 15% dhe përmbajtje e paverifikuar me 13%. Artikujt e kategorizuar si “Clickbait” përfshihen në kronikën e zezë dhe çështjet sociale, si vrasje, plagosje, programi televiziv BBVA, emigrantët, platforma “Superpuna” etj. Vlerësime “Lajm i rremë” kryesisht kanë marrë përmbajtjet keqinformuese të mediave për Gjykatën Speciale, ish-presidentin Thaçi, kryeministrin shqiptar, Rama, veriun e Kosovës etj. Ndërkaq, kategoria “Përmbajtje e paverifikuar” më së shumti ka trajtuar temat e sigurisë për veriun e Kosovës dhe komunitetin serb në vend.

Në këtë periudhë njëmuajore (prill 2023), tema kryesore e trajtuar nga mediat për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes keqinformuese është veriu i Kosovës. Mediat reale në gjuhën serbe kanë publikuar më së shumti keqinformime për veriun, ndërsa edhe disa llogari e faqe në mediat sociale kanë shpërndarë në gjuhën shqipe artikuj keqinformues për veriun e vendit. Tema të tjera të trajtuara janë vrasje, programi televiziv BBVA, arrestime, plagosje etj. Pavarësisht se tema e veriut të Kosovës, si temë politike dhe e sigurisë, ka dominuar mbi temat tjera, megjithatë kronika e zezë me 29% dhe çështjet sociale me 24% kanë mbizotëruar ndaj çështjeve politike (20%) dhe të sigurisë (14%), si fushat kryesore të keqinformimit për muajin prill 2023. Pothuajse të gjitha publikimet keqinformuese për kronikën e zezë, temat sociale dhe politikën janë krijuar dhe shpërndarë nga mediat në gjuhën shqipe, ndërsa shumica dërrmuese e artikujve në fushën e sigurisë janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe.

Gjatë monitorimit për muajin prill 2023, vërehet se mediat reale kanë shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese për Kosovën me 48% kundrejt faqeve, faqeve zyrtare dhe llogarive në mediat sociale prej 40%. Ndërkaq, rreth 12% e artikujve keqinformues janë publikuar dhe shpërndarë nga portalet e dyshimta. Shumica dërmuese e artikujve keqinformues të publikuar nga mediat në gjuhën shqipe janë për kronikën e zezë, çështjet sociale dhe sportin, ndërsa fokusi i mediave në gjuhën serbe është tek temat e sigurisë për veriun e Kosovës dhe komunitetin serb në vend. Lidhur me mediat sociale, në Facebook janë krijuar dhe shpërndarë më së shumti publikime keqinformuese prej 62% dhe në TikTok 38%. Të gjitha publikimet në mediat sociale janë shpërndarë në gjuhën shqipe nga faqe, faqe zyrtare dhe llogari të ndryshme në këto dy media sociale, në të cilat mbizotërojnë temat politike, sociale dhe kronika e zezë, pasuar nga siguria, shpalljet dhe sundimi i ligjit.

Institucioni më i përfolur nga media të ndryshme në muajin prill 2023 është Policia e Kosovës. Mediat në gjuhën serbe kanë përfolur Policinë në kontekst të veriut të Kosovës, në pretendimet e tyre të pavërteta se Policia e Kosovës ka plagosur një qytetar serb në veri të vendit. Edhe llogari në mediat sociale, në gjuhën shqipe kanë publikuar lajme të rreme, duke pretenduar pa fakte se grupi rus “Wagner” ka plagosur shtatë pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe se kjo e fundit ka vrarë tre qytetarë serbë. Edhe këtë muaj (prill 2023), personaliteti më i përfolur është kryeministri Albin Kurti nga mediat në gjuhën shqipe dhe serbe. Mediat serbe kanë shpërndarë artikuj me përmbajtje të rreme se institucionet kosovare dhe Kurti po planifikojnë spastrimin e serbëve nga veriu i vendit, ndërkaq disa faqe në mediat sociale, në gjuhën shqipe, kanë publikuar përmbajtje keqinformuese duke nxjerrë jashtë kontekstit deklarata të Kurtit.

HIBRIDO.INFO